



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**SHOQERIA UJESJELLES KANALIZIME BERAT-KUÇOVE SHA
ASAMBLEJA E AKSIONAREVE**

Nr. 04 prot.

Berat, më 31.07.2023

V E N D I M

Nr. 03 datë 31.07.2023

P Ë R

MIRATIMIN E PËRFUNDIMIT TË LIKUIDIMIT DHE ÇREGJISTRIMIN E SHOQËRISË

Sot, më datë 31 Korrik 2023, Shoqëria Ujesjellesi Berat-Kuçove Sh.A, një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, me kodin unik NIPT J62903166T, mbajti mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve. Mbledhja u thirr nga likuidatori i shoqërisë zoti Polizoj Ikonomi, për të diskutuar mbi rendin e ditës si vijon:

- Përfundimi i procedurave të likuidimit dhe çregjistrimi i Shoqërisë Ujesjellesi Berat-Kuçove Sh.A.

Në shqyrtim të rendit të ditës, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve vëren:

Shoqëria Ujesjellesi Berat-Kuçove Sh.A është shpallur në likuidim në datën 25.04.2023. Vendimi si dhe njoftimet e kreditorëve janë publikuar rregullisht në QKB. Shoqëria nuk ka pasur aktive dhe detyrime, pasi në tërësi aktiviteti ekonomik dhe aktivet se bashku me detyrimet janë transferuar në favor të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizimeve Berat Sh.A. në datë 31.12.2022.

Pasi u shqyrtua Bilanci në çastin e hapjes së likuidimit i datës 25.04.2023, si dhe pasi u shqyrtua Bilanci përfundimtar i mbylljes së procedurave të likuidimit i datës 31.07.2023 si dhe Raporti i likuidatorit, konkludohet se shoqëria nuk disponon me asete dhe nuk ka detyrime ndaj të tretëve apo ndaj autoriteteve publike. Gjithashtu, shoqëria nuk zhvillon më aktivitet ekonomik dhe në këtë mënyrë mund të deklarohet mbyllja e procedurave të likuidimit dhe shoqëria mund të çregjistrohet.

Pasi diskutoi gjerësisht mbi çështjen më sipër të rendit të ditës, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve unanimisht

V E N D O S I:

- (1) Miratimin e bilancit të gjendjes në çastin e hapjes së likuidimit në datë 25.04.2023 si dhe pasqyrave financiare për periudhën 1 Janar 2023 deri 25 Prill 2023 si dhe rezultatit financiar prej 0 (zero) lekë për këtë periudhë.
- (2) Miratimin e bilancit të gjendjes në çastin e mbylljes së likuidimit në datë 31.07.2023 si dhe pasqyrave financiare për periudhën 25 Prill 2023 deri 31 Korrik 2023, si dhe rezultatit financiar prej 0 (zero) lekë për këtë periudhë.
- (3) Miratimin e raportit të likuidatorit të datës 31 Korrik 2023.
- (4) Të drejtat ndaj Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat Sh.A. shpërndahen dhe kalojnë në favor të aksionarëve në përputhje me pjesëmarrjen në kapital si vijon:

Aksionari	Përqindja e pjesëmarrjes	Vlera në Lekë e të drejtave në SHRUK Berat SHA
Bashkia Berat	65.32%	567,091,243
Bashkia Kuçovë	34.68%	301,082,736
TOTAL	100.00%	868,173,979

- (5) Mbylljen e fazës së likuidimit, prishjen e shoqërisë dhe çregjistrimin e Shoqërisë Ujësjellesi Berat-Kuçovë Sh.A nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.
- (6) Ngarkohet likuidatori me zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E AKSIONAREVE TË UJESJELLESIT BERAT-KUÇOVË SH.A

Bashkia Berat
KRYETARI

Ervin DEMO



Bashkia Kuçovë
KRYETARI

Kreshnik HAJDARI

